



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:006298

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05610685

KPPP.nr. 1757/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbare të kreditorit N.T.P. “Aliu”, me numër të regjistrimit të biznesit 810633645, me seli në fshatin Gjinoc, Suharekë, kundër debitorit N.N.P. “Euro Construction”, me numër unik identifikues 810740945, me seli në fshatin Ratkoc, Rahovec, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr.120/20 të datës 13.07.2020, të Përmbaresit Privat Saranda Kuçi, me seli në Prizren, jashtë seancës me datë 23.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.N.P. “Euro Construction” dhe Urdhri Përmbare P.nr.120/20 i datës 13.07.2020, i lejuar nga Përmbaresi Privat Saranda Kuçi, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “N.T.P. “Aliu” ka lëshuar Urdhrit Përmbare P.nr.120/20 të datës 13.07.2020, me të cilin e ka lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës Nr.132/2019 të datës 11.11.2019, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej (7) shtatë ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 1,713.00€, (njëmijë e shtatëqind e trembëdhjetë euro) në emër të borxhit me kamatë ligjore 8% nga dita e kalimit të afatit për pagesë deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbareme nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbaresi privat do të zbatoj përmbaremin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit me shitjen e tyre duke bërë kështu ekzekutimin e pagesës së borxhit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarrimit, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim, në të cilin e ka kundërshtuar në tërësi borxhin ndaj kreditorit duke konsideruar se i njëjti është inekzistent. Ka shtuar se bazuar në faturën me të cilën është iniciuar procedura përmbarrimore, organi përmbarrimorë nuk është dashur fare ta lëshoj urdhrin pasi që sipas debitorit, ai nuk ka pasur asnjë marrëdhënie kontraktuale me kreditorin. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj në tërësi prapësimin e debitorit dhe të anuloj urdhrin përmbarrimor.

Kreditori brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara. Më tej ka theksuar se dokumenti në bazë të së cilit është iniciuar kjo procedurë përmbarrimore përmban të gjitha elementet e përcaktuara me dispozita ligjore dhe se është titull ekzekutiv. Prapësimin e debitorit e ka konsideruar si të pa bazë pasi që i njëjti nuk gjen mbështetje në asnjërën nga shkaqet e përcaktuara për prapësim me nenin 71 të LPP-së. Andaj i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar dhe të lë në fuqi urdhrin përmbarrimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarrimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarrimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarrimore të përfundohej në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarrim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 paragrafit 1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”* dhe me paragrafin 3 të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti i besueshëm, Fatura Nr.132/2019 e datës 11.11.2019 në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarrim nuk i plotëson kushtet

ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në bazë të së cilës është mbështetur propozimi për përmbarrim dhe është lejuar urdhri përmbarrimor është bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar siç kërkohet me nenin 37 të LPP-së.

Në këtë drejtim, rezulton se propozimi për përmbarrim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, përmban të meta ngase në propozim nuk janë treguar dokumentet origjinale apo kopja e vërtetuar mbi bazën e të cilëve është iniciuar procedura përmbarrimore, ashtu siç përcaktohet me dispozitën nga neni 38 paragrafi 1 i LPP-së: i cili përcakton se *“Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*.

Sipas nenit 43, par.4 të LPP-së përcaktohet se: *“...Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrit të përmbarrueshmërisë së nxjerrë nga përmbarruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarrimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbarruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarrim nga përmbarruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*.

Andaj, nga të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbarrimit P.nr.120/20 i datës 13.07.2020, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase fillimisht propozimit për përmbarrim i është bashkëngjitur fatura e nënshkruar dhe vulosur vetëm nga kreditori ndërsa pas Konkluzionit PPP.nr. 66/20 të datës 04.04.2023 të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit të besueshëm dhe rrjedhimisht propozimi për përmbarrim përmban të meta në kuptim të nenit 38 paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarrim, ndërsa organi përmbarrues - përmbarruesi privat, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se propozimi për përmbarrim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues*

apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”.

Nga sa u tha më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1757/23, datë 23.04.2024.

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.